
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje pajisje kompjuterike ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pajisje kompjuterike__ 30237200-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 465 724 (dy milion e katerqind e gjashtedhjet e pese mije e shtateqind e njezet e kater) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. I ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 8, pika 1 "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit"

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e perllogaritur duhet të jetë jo më e vogël se 986 289.6 leke pa tvsh leke pa tvsh (40%) të vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë **arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar** nga autoriteti/enti kontraktor".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 55, pika 4, "Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së perllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave". Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM "Për rregullat e prokurimit publik", e cila parashikon se Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore)

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare të certifikuar nga organet tatimore (2022, 2023, 2024), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshur “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare*”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese. Si dhe Ligjin nr 8438 dt 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar ,ku theksohet ”Cdo tatim pages per gatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuara ne Udhezimin e Ministririt te Financave ne zbatim te ketij ligji.Tatimpagesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin e fundit., sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” I ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.2.4Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 493 144.8 lek pa tvsh lek pa tvsh (20%) të vlerës së të vlerës së fondit të limit të kontrates

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda vlerës limit të kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik, duke qenë një kontratë e rëndësishme, mbështetur në sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt prokurimi. Kjo kërkesë i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën e cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë). Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

- **Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.
- Duke qenë se paisjet e kërkuara janë për sisteme sigurie si dhe teknologjia e kërkuar është në një nivel të lartë duhet që subjektet zbatuese të kontratës të jenë të pajisura me këto certifikime.

- Përmbushja e standartit **ISO 9001: 2015 ose ekuivalente** është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kërkojnë. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për
- shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

2.2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për produktet objekt kontrate, ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkojnë në këtë prokurim, i garanton gjithashtu AK se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kërkojnë të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë.

2.2.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë transportin e mallrave pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor,

Argumentimi: Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkojnë që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me anë të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektivit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

2.2.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë garancie për artikujt e kërkuar dhe në rast shpallje fitues duhet ti lëshojë Autoritetit Kontraktor .

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër se mallrat objekt prokurimit janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara si dhe marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimi ose riparimi, mirëmbajtja dhe shërbimi pa pagesë.

2.2.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mallrat e ofertuar janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti/Enti Kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Vendosja e këtij kriteri, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se Operatori Ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet paraqitjes së një deklarate, të vërtetojnë dhe garantojnë AK, se të gjitha mallrat e ofertuara, janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

-

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për furnizimin me paisjet elektronike duke u mbështetur në standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

. Specifikimi i Materialeve:

Nr	Pershkrimi	Sasia	Njesia
1	PDA per leximin e matesave	8	cope
2	Kompjuter Desktop 2	8	cope
3	Laptop Advanced	2	cope
4	Wireless access point ,stacion (23dBi (antena)	4	cope

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. PDA per leximin e matesave

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Processor:	Octa – Core
RAM:	2GB RAM
Memorie e Brendëshme “Internal Memory”:	16 GB Flash memory
Slot per rritje memorje	One 128GB micro SD slot
Display:	4.3 in. color WVGA (800x480); LED backlight;
	Corning Gorilla Glass
Audio	Speaker – 1 Watt (94dBA)
	Voice support (Internal speaker/microphone)
	2 microphones
	Audio jack
Sensor	Accelerometer (3-axis), ambient light sensor, proximity sensor
Bateria “Battery”:	3000 mAh
Rear camera	8MP autofocus color camera with flas
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	

	Wireless 802.11a/b/g/n; Bluetooth min. V 4.2;
Mbyllje hermetike	IP54
Specifikimet e renjes	300 renie, 0.5 m
Siguria	Verified Boot, WPA/WPA2 (PSK & Enterprise 802.1x); EAPTTLS; PEAPv0-MSCHAPv2; EAP-TLS
Sistemi i Operimit	Android Ore 11
Temperatura e Operimit	-10° C to 50° C
AKSESORËT	
Ushqyesi “Recharger”:	Po
Pesha	Jo me shum se 195 g
Te perfshire aksesore	Cante Mbajtese.
GARANCIA	1 Vit garanci

5 - Wireless access point ,stacion(23dBi (antena)

#08180 - Standards	IEEE 802.11a, IEEE 802.3u
Ports	1x 10/100 Mbps RJ-45
Operating modes	Access Point, Bridge, Client, WDS, Router,station
Chipset Atheros	MIPS 24KC, 400MHz
Operating memory	32 MB SDRAM
Flash memory	8 MB
Frequency range	5475MHz - 5825MHz
Antenna	build-in, 23 dBi

Weight	1.65 kg
Grid dimensions	279.4 x 355.6 mm
Mounting	mast or wall with the aid of antenna wall support
Max. power consumption	3 W
Power	PoE 24V
Operating temperatures	-30°C ÷ 75°C
Operating humidity	5% ÷ 95%, ondensing
Manufacturer	

Kompjuter Desktop 2

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. Për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	11500 Pikë
“RAM”:	8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC
Madhësia e Hard Diskut “SDD Size”	256 GB SDD
“Disk Subsystem Controler”:	Serial ATA III 6.0 Gb/s
Karta Grafike “Graphics”:	Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 2 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe adaptor)
“Media Device”:	DVD+/-RW
“Slots”:	Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (8) USB nga të cilat: a. Min. (3) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. And (1) Headphone, (1) Portë Video (mund të përdoret dhe adaptor)
Rrjeti “Networking”:	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
“Sound”:	Integrated Sound Card
“Speakers”:	Internal or Built-in Monitor
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional
Te perfshira	Licensë Platforme Menaxhimi Virtual
Tastiera “Keyboard”:	Standart Keyboard QWERTY
“Mouse”:	Minimum 3 Button Scroll Optical

Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition
MONITORI	
Tipi “Type”:	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia “Size”:	≥ 21”
Rezolucioni “Native Resolution”:	1920 x 1080 at 60 Hz
Raporti i Kontrastit “Contrast Ratio Static”:	1000:1
“Display Port”:	(1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI
Koha e Rifreskimit “Response Time”:	≤ 6 ms
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

Per pajisjet Kompjuter Desktop 2 qe do te levrohen dhe instalohen duhet të kenë të përfshirë
Licensë Platforme Menaxhimi Virtual sipas specifikimeve të mëposhtme:

Platformë	Duhet të jetë appliance virtuale.
Funksionet kryesore dhe licencimi	Platforma e ofruar duhet të jetë në zgjidhje që ofron menaxhim të unifikuar për pajisjet kompjuter nga prodhues të ndryshëm. Platforma të jetë e licencuar për të gjitha pajisjet kompjuter desktop 2 të ofertuara duke përfshirë të gjitha funksionet e kërkuara. Zgjidhja duhet të mundësojë instalim “nga zero” të kompjuterave. Zgjidhja duhet të mundësojë instalim 10icence10 të ri apo upgrade të kompjuterave. Zgjidhja duhet të mundësojë përdorues të rinj të kompjuterave. Zgjidhja të mundësojë instalimin nga distanca për platformat Windows. Zgjidhja të mundësojë menaxhimin njëkohësisht të sistemeve të ndryshëm.
Konfigurim	Zgjidhja duhet të mundësojë dispozitat si më poshtë për platformat Windows:

	Multicasting. Menaxhimi i Integruar i driver-ave. Migrimi i Integruar të gjendjes të përdoruesëve. Instalimi i automatizuar e programeve kompjuterike;
Menaxhimi dhe administrimi	Të përdori model të bazuar në role për akses administrator. Të ofrojë menaxhim sipas nevojave. Të jetë 11licence e përhershme.

Laptop Advanced

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët min. Për procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net:	12200 Pikë
“Chipset”:	Intel ose Ekuivalent
“RAM”:	16 GB, min. DDR4 2666 MHz
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	≥ 500 GB SSD
“Graphics”:	Dedicated Graphics with min. 4 GB Memory
“Media Device”:	DVD+/-RW DL Internal ose External e të njëjtës Markë me Laptop-in;
Memory Card Reader	
Ekrani “Display”:	15.6” FHD LED (1920 x 1080), Anti Glare
Bateria “Battery”:	Min. 60 Wh
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (3) porta USB nga të cilat min. (3) USB 3.0/USB 3.1 (1) DP/HDMI (1) Integrated Mic. (1) Integrated HD Web Camera (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack
Rrjeti “Networking”:	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11b/g/n); Bluetooth min. V4.1;
“Sound”:	Integrated, (2) x built-in Speakers (stereo)
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional
Te perfshira	Licensë Platforme Menaxhimi Virtual

Tastiera “Keyboard”:	QWERTY
“Pointing Device”:	Touch Pad
Siguria “Security”:	Embedded Security TPM 2.0
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Ushqyesi “Recharger”:	Po
“Mouse”	Po, i të njëjtës Markë me Laptopin
Çanta “Carrying Bag”:	Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë.
“Recover”:	Recover Partition
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

Per pajisjet Laptop Advanced qe do te levrohen dhe instalohen duhet të kenë të përfshirë Licensë Platforme Menaxhimi Virtual sipas specifikimeve të mëposhtme:

Platformë	Duhet të jetë appliance virtuale.
Funksionet kryesore dhe licencimi	Platforma e ofruar duhet të jetë në zgjidhje që ofron menaxhim të unifikuar për pajisjet kompjuter nga prodhues të ndryshëm. Platforma të jetë e licencuar për të gjitha pajisjet Laptop Advanced të ofertuara duke përfshirë te gjitha funksionet e kërkuara. Zgjidhja duhet të mundësojë instalim “nga zero” të kompjuterave. Zgjidhja duhet të mundësojë instalim 12icence12 të ri apo upgrade të kompjuterave. Zgjidhja duhet të mundësojë përdorues të rinj të kompjuterave. Zgjidhja të mundësojë instalimin nga distanca për platformat Windows. Zgjidhja të mundësojë menaxhimin njëkohësisht të sistemeve të ndryshëm.
Konfigurim	Zgjidhja duhet të mundësojë dispozitat si më poshtë për platformat Windows: Multicasting. Menaxhimi i Integruar i driver-ave. Migrimi i Integruar të gjendjes të përdoruesëve.

	Instalimi i automatizuar e programeve kompjuterike;
Menaxhimi dhe administrimi	Të përdori model të bazuar në role për akses administrator. Të ofrojë menaxhim sipas nevojave. Të jetë 13icence e përhershme.

Komisioni